

BREAKING NEWS

x

SONDAZHI/ KY ESHTË POLITIKANI ME I PELQYER NGA SHQIPTARET 4 MUAJ PARA ZG...

AKTUALITET

Parandalohet vrasja e dyfishtë në Kamëz, arrestohen në flagrancë 2 autorët e dyshuar

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
29 QERSHOR 2019

Facebook

WhatsApp

Twitter

Email



Një konflikt mes disa personave mesditën e djeshme në hyrje të Kamzës nëse policia nuk do të ndërhynte në kohë do të përfundonte në një kasapanë të vërtetë. Disa persona janë përfshirë në një konflikt të dhunshëm mes tyre ku përveç sharjeve dhe ofendimeve ndaj njëri-tjetrit, janë konfliktuar dhe fizikisht. Kanë qenë të paktën 5 persona që janë përfshirë në këtë konflikt në periferi të kryeqytetit në Valias. Sipas dëshmitarëve sherri ka nisur për një parakalim ku pas debateve nga automjetet ato kanë dalë në rrugë dhe janë konfliktuar mes tyre. Kjo ngjarje e rëndë

për pak mund të përfundonte në një vrasje të dyfishtë por falë ndërhyrjes së shpejtë të policisë pas marrjes së informacionit për këtë konflikt ka bërë të mundur parandalimin e kësaj ngjarjeje. Për këtë ngjarje janë arrestuar dy persona shokë me njëri-tjetrin, të cilët janë kapur në flagrancë me një kallashnikov me të cilin dyshohet se do të ekzekutonin dy personat që u konfliktuan për parakalimin. Në prangat e uniformave blu përfunduan Blertjan Sulejmani, 40 vjeç dhe Safedin Satka, 39 vjeç, banues në Valias. Ky i fundit është person me precedent pasi rezulton se është dënuar më parë për veprën penale “Plagosja e rëndë me dashje”. Burime bëjnë me dije se pas sherrit fizik dy të arrestuarit janë larguar dhe kanë shkuar të marrin një armë zjarri tip kallashnikov, e cila ishte me dy karikatorë me fishekë, por fatmirësisht janë ndaluar në kohë nga policia. Po në cilësinë e provës materiale është bllokuar dhe automjeti i autorëve të kësaj ngjarjeje tip Porsche Cayenne. Prokuroria e Tiranës do të nisë hetimet për veprat penale “Vrasja me dashje” e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”.

Parandalimi i krimit të dyfishtë

Mesditën e djeshme policia e Tiranës nëpërmjet një njoftimi zyrtarë për mediat tha se ka parandaluar një vrasje të mundshme në Kamëz. Sipas policisë marrja në kohë e informacionit si dhe ndërhyrja me profesionalizëm e forcave të policisë së komisarit nr.5, parandaloi një konflikt i cili mund të kishte përfunduar me të paktën 2 viktima. Shërbimet e policisë të Komisarit Nr. 5 Tiranë, pas marrjes së informacionit se në Valias po ndodhte një konflikt i ashpër midis disa personave, organizuan menjëherë punën dhe me veprimet e shpejta dhe profesionale bënë të mundur parandalimin e mëtejshëm të këtij konflikti duke arrestuar në flagrancë dy personat të cilët mund të qëllonin me armë zjarri ndaj dy shtetasve që ata u konfliktuan. Sipas burimeve zyrtare një nga të arrestuarit më konkretisht 39-vjeçari